



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 368/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, Kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i koalicionit politik PDK-AAK-NISMA, Muhamet Bojkaj nga fshati Isniq, Komuna Deçanit, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga përfaqësuesi i koalicionit PDK-AAK-NISMA, Muhamet Bojkaj, nga fshati Isniq, Komuna e Deçani, për shkak të rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve(KQZ).

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 10:55 , ka pranuar një ankesë nga Muhamet Bojkaj nga fshati Isniq Komuna e Deçanit, në të cilën në ankesën e pretenduar thekson që kryerës i supozuar është subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje nga kryesuesi në vendvotimin 0108c/01R, dhe mendoj se ka pasur parregullsi gjatë procesit të numërimit pasi që aty ku unë dhe familja ime kemi votuar për kandidatin e caktuar ku pas numërimit kandidatit në FRP nuk i ka ndaluar asnjë votë, koalicioni PAN 12 , me kandidatin për deputet Bekë Berisha me nr.106. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi, dëshmitar Durim Balaj, vëzhgues .

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimor, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të arsyeshme për ti vërtetuar ato pretendime edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës.

Prandaj PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.368/2017 më datën 01.07.2017



Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi

Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*